

*Social
Creativity*

www.social-creativity.org

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	08.10.2020		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400-	42758		



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Në mes të

OJQ SOCIAL CREATIVITY

dhe

KOMUNËS SË DRENASIT

OJQ Social Creativity dhe Komuna e Drenasit pajtohen për bashkëpunim të afërt me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe përkrahjes për gratë e marginalizuara në Komunën e Drenasit.

Neni 2

QËLLIMI I MEMORANDUMIT

2.1 Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimi (MB) është mbështetja financiare për ndërtimin e pesë (5) serrave që do të ndërtohen në vitin 2020 në Komunën e Drenasit, në vlerë totale prej **3,050.00 €**.

Neni 3

AUTORITETET

3.1 Qëllim i Memorandumit do të përbushet nga:

- OJQ Social Creativity dhe
- Komuna e Drenasit.

Neni 4

OBLIGIMET PALËVE

4.1 OBLIGIMET E SHOQATËS OJQ SOCIAL CREATIVITY

- 4.1.1 Investon mjetet financiare në vlerë prej **2,250.00 €** për ndërtimin e pesë(5) serrave, si dhe furnizim me udhëzues pér kultivimin dhe mirëmbajtjen e bimëve;
- 4.1.2 Zhvillon procedurat pér përzgjedhjen e ofertave për ndërtimin e serrave;
- 4.1.3 Përzgjedhjen e grave përfituese e bënë shoqata OJQ SOCIAL CREATIVITY në bashkëpunim me shoqatën Qendra për Promovimin e drejtave të Grave (QPDG)- Drenas;
- 4.1.4 Në bashkëpunim me Komunën e Drenasit kujdesen për implementimin e projektit.

4.2 OBLIGIMET E KOMUNËS SË DRENASIT

- 4.2.1 Investon mjetet financiare në vlerë prej **800.00 €** (tetëqind euro) të shumës së projektit për ndërtimin e pesë (5) serrave në qytetin e Drenasit sipas ANKESIT 1 të buxhetit.

ZBATIMI

5.1 OJQ SC përcjell zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzon për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve deri në momentin e realizimit të qëllimit.

Neni 6

ZGJATJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJËS

- 6.1 Palët me marrëveshje të dyanëshme me shkrim, kanë mundësi të zgjasin apo ndryshojnë dhe plotësojnë këtë marrëveshje;
- 6.2 Në rast të mosmarrëveshjes/paknaqësisë nga ndonjëra palë, Memorandum Bashkëpunimi mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim një (1) muaj më parë.

Neni 7

KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT

7.1 Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje original në Gjuhën Shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

Neni 8

AFATI I REALIZIMIT

8.1 Afati i realizimi të projektit në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2020.

Neni 9

HYRJA NE FUQI

9.1 Ky Memorandum Bashkëpunim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

OJQ Social Creativity
Prishtinë 08.10.2020

